



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:075085

Datë: 25.04.2019

Numri i dokumentit: 00291132

P.nr.139/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me procembajtësen Berna Maliqi, në çështjen penale kundër të pandehurit....., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.180/2019, të datës 05.02.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 25.04.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër Nd.93/2019, e datës 11.04.2019, e lidhur në mes të pandehuritdhe të dëmtuarës..., e arritur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gj.....
- II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.180/2019, e datës 05.02.2019 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të ...nga fshati....., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, për shkak se i pandehuri dhe e dëmtuara kanë arritur marrëveshjen për ndërmjetësim.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 06.02.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.180/2019, kundër të pandehurit..., Komuna e Gj....., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës.

Më datë 04.03.2019, gjykata sipas detyrës zyrtare dhe duke u bazuar edhe në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjin për Ndërmjetësim me numër 06/L-009, çështjen penale me numër P.nr. 139/2019, kundër të pandehurit....., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni

321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, e ka dërguar në procedurën e ndërmjetësimit, me çrast me datë 11.04.2019, pranë zyrës për ndërmjetësim në këtë gjykatë është arritur marrëveshja me numërr Nd.../2019, sipas të cilës i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe një kohësisht të dëmtuarës -Distrikti në Gj..., i ka bërë kompensimit e dëmit të shkaktuar si pasojë e veprimeve të tij ndërsa e dëmtuara pas kompensimit të dëmit nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit dhe se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj tij sepse kompensimin e dëmit tanimë e kanë realizuar, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga fletëpages ee datës 11.04.2019.

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat si dhe në bazë të nenit 358 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të KPP-së dhe nenit 2, 4, 8, 14, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.139/2019, me datë 25.04.2019

Procesmbajtësja,
Berna Maliqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.